

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNA FAN, MIRDITË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komuna Fan, Mirditë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri më 31.10.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 14, datë 20.02.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1072/8, datë 20.02.2015, i ka rekomanduar z. Gjergj Prenga, Kryetar i komunës Fan, Mirditë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit është konstatuar se nuk janë përcaktuar si duhet Objektivat, Misioni dhe Vizioni i Komunës Fan dhe nuk informohen si duhet menaxherët dhe punonjësit e njësive publike në lidhje me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë, nuk është hartuar dhe miratuar Kod Etik për Institucionin dhe strukturat në veçanti, në përputhje me nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Mjedisi i kontrollit”, ka pamjaftueshmëri dokumentacioni lidhur me pasqyrimin e këtij komponenti të MFK. Strategjia e risqeve nuk është miratuar dhe nuk është identifikuar risku sipas nenit 21 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nuk është bashkëpunuar me menaxherët e tjerë të institucionit për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ato drejojnë, nuk janë marrë masa trajnuese për njohjen e këtij ligji dhe vënien në zbatim të tij, kjo edhe nga mosnjohja e këtij ligji nga një pjesë dërrmuese e administratës së Komunës .

Rekomandim: Komuna Fan të marrë masa që të përcaktohen objektivat, misioni dhe vizioni i komunës, të hartohet dhe miratohet Kodi Etik, të miratohet dhe të identifikohet risku, të krijohet regjistri i riskut, të bëhet vlerësimi dhe kontrolli i tij, të merren masa trajnuese për njohjen e ligjit për MFK si dhe për vënien në zbatim të tij.

Brenda muajit Maj 2015

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nga sektori i Financës Komuna Fan nuk është paraqit për miratim në këshillin e komunës realizimi faktik i buxhetit për vitin 2012, 2013 dhe 2014 në veçanti, në kundërshtim me nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar .

Rekomandimi: Komuna Fan të marrë masa për analizimin e projektvendimit, për mbylljen e buxhetit të vitit të mëparshëm sipas afateve të parashikuara në ligj.

Brenda muajit Maj 2015

2.1 Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit evidentohet se shpenzimet sipas planit për vitin 2012 rezultojnë në vlerën 27,110 mijë lekë, për vitin 2013 në vlerën 25.463 mijë lekë dhe 10 mujorin e vitit 2014 në vlerën 26.207 mijë lekë, vlera të cilat nuk rezultojnë të rakorduara sipas miratimeve të buxhetit me vendime të Këshillit komunës për vitet 2012 - 2014.

Sa më sipër rezulton se nga komuna, treguesit financiar i ka planifikuar me rezerva, që tregon për një punë të pa mjaftueshme në planifikimin e shpenzimeve në buxhetin vendor, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

Rekomandimi: Zyra e financës e komunës, të marrë masa për rakordimin e treguesve buxhetor të miratuara në Këshillin e komunës me treguesit e evidentuara nga dega e thesarit duke pasur parasysh ndryshimet gjatë vitit.

Brenda muajit Maj 2015

2.2 Gjetje nga auditimi: *Analizë e shpenzimeve operative (Ilogaria 602).*

Si rrjedhojë e mos rakordimit të dhënave të shpenzimeve të evidentuar në thesar llog. 602 me treguesit e buxhetit, rezulton se shpenzimet e buxhetit për vitin 2012 nuk janë realizuar në vlerën 1,957 mijë lekë, për vitin 2013 me mos realizim 2,873 mijë lekë dhe nuk është rakorduar me thesarin sipas zërave me analizë të llogarisë 602.

Rekomandimi: Zyra e financës e komunës të marrë masa, për rakordimin me thesarin në mënyrë analitike sipas analizës së llogarisë 602(shpenzime operative).

Brenda muajit Maj 2015

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë u konstatua se; bashkëlidhur projektvendimit të ndihmës ekonomike të miratuar për çdo muaj, nuk ndodhet relacioni përkatës, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 338/3, datë 10.3.2006, mbi zbatimin e kapitullit XI, pika 3 e VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, për llogaritjen e ndihmës ekonomike në të gjitha rastet nuk janë llogaritur të ardhurat nga blegtoria .

Rekomandim: Komuna Fan të marrë masa, që në dokumentacionin e ndihmës ekonomike e të aftësisë së kufizuar të hartohet relacioni përkatës, si dhe të llogariten të ardhurat nga blegtoria.

Brenda muajit Maj 2015

3.1. Gjetje nga auditimi: Për 170 për familjet që trajtoheshin me ndihmë ekonomike, rezultuan me të meta dhe mangësi si në certifikatën familjare gjatë viteve 2012 dhe 2013 nuk pasqyrohet data e vendosjes nga ku ka ardhur, në të gjitha rastet dosjet e ndihmës ekonomike dhe të personave që trajtohen me pagesë paaftësie janë pa inventarizuar,- për vitin 2012 deri me 30.09.2014, në të gjitha rastet deklarata model 2, nuk është plotësuar nga të gjithë personat madhor, në 65% te rasteve kanë certifikata pronësisë, lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe 35% *Aktin i marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës* si dhe nuk zbatohet pikat 24-30 të VKM nr. 1053, datë 23.04.2008 “Për disa ndryshime të VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike”. Në shumë raste mungon certifikata e pronësisë së tokës, si dhe nuk është zbatuar pika 27 e në vazhdim e VKM nr. 1053, datë 23.04.2008, “Për projektet me punë në komunitet, si detyrim për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.

Rekomandim: Komuna Fan të marrë masa, që dosjet e ndihmës ekonomike dhe të personave që trajtohen me pagesë paaftësie të inventarizohen, të plotësohet deklarata model 2 dhe të plotësohen me certifikatat e pronësisë së tokës.

Brenda muajit Maj 2015

3.2. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Këshillit të komunës nuk janë miratuar projektet e punëve komunitare apo të shërbimeve shoqërore, me kohë të plotë pune; listën e personave, që do të marrin pjesë në zbatimin e projekteve, me kohë të plotë pune; objektet ku do të ndërhyhet, kalendarin dhe vëllimin e punimeve për projektet, me kohë të pjesshme pune, si dhe në përdorimin e fondeve, duhet të hartojnë programe monitorimin, për të gjitha programet sociale.

Rekomandim: Komuna Fan të marrë masa, që të miratojë projektet e punëve komunitare apo të shërbimeve shoqërore me kohë të plotë pune, duke shoqëruar me dokumentet e nevojshme si: listën e personave që do të marrin pjesë në zbatimin e projekteve, objektet ku do të ndërhyhet, kalendarin dhe vëllimin e punimeve për projektet, me kohë të plotë apo të pjesshme pune, si dhe në përdorimin e këtyre fondeve të hartojnë programe monitorimin, për të gjitha programet sociale që do të kryhen.

Brenda muajit Maj 2015

4. Gjetje nga auditimi: Në dokumentacionin shoqërues të listë pagesave, u konstatua se në zbatim të vendimeve të mësipërme, në lidhje me klasifikimin e funksioneve, sipas grupimit të njësive të qeverisjes vendore, struktura nuk është klasifikuar sipas Klasave për çdo pozicion pune, sipas kërkesave të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “”, i ndryshuar.

Rekomandim: Komuna të marrë masa për klasifikimin e vendeve të punës sipas funksioneve, dhe klasave në zbatim VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 sipas vendit të punës dhe arsimit përkatës.

Brenda muajit Maj 2015

5. Gjetje nga auditimi: Nëpunësi zbatues dhe autorizues nuk kanë përgatitur dhe miratuar një dokument ku të përshkruajnë organizmin dhe procedurat kontabël, i cili është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditimit, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”.

Rekomandim: Nëpunësi zbatues dhe autorizues të përgatit një dokument ku të përshkruajë organizmin dhe procedurat kontabël, i cili është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditimit.

Menjëherë

5.1. Gjetje nga auditimi: Nëpunësi autorizues nuk ka kryer investime në Teknologjinë e Informacionit për programe në fushën e administrimit financiar etj. për rritjen e efektivitetit të përdorimit të informacionit financiar, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM Nr. 25 datë 20.01.2001.

Rekomandim: Nëpunësi autorizues të marrë masa, për informatizimin në fushën e administrimit financiar për rritjen e efektivitetit të përdorimit të informacionit financiar, me qëllim që të ndiqet gjurma e konsumit apo e amortizimit të aktiveve.

Menjëherë

5.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të viteve 2012-2013, konstatohet se nuk janë saktësuar në mënyrë analitike aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe aktivet qarkulluese, në mbështetje të inventarit fizik dhe kontabël, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimit të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Nëpunësi zbatues të saktësojë sipas analizave aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, në mbështetje të inventarizimit kontabël dhe fizik.

Brenda muajit Maj 2015

6. Gjetje nga auditimi: Në Komunën Fan të ardhurat nga taksat e tarifat vendore për vitin 2013 në shumën 1,199 mijë lekë, nga 2,000 mijë lekë të programuara me diferencë **më pak 801 mijë lekë** dhe 11 mujori i vitit 2014 është realizuar në shumën 744 mijë lekë, nga 1,920 mijë lekë të programuara me diferencë **më pak 1,176 mijë lekë** ose në masën 38,7 %. Mosrealizimi për vitet 2013 dhe kryesisht për vitin 2014, ka ardhur nga mos arkëtimi i taksës së pasurisë së paluajtshme, taksa e tokës bujqësore, taksë e zënies së hapësirës publike si dhe tarifat e pastrimit.

Treguesit e mësipërm paraqesin një performancë të ulët të administratës fiskale të Komunës Fan, gjë e cila ka ndikuar dhe në mos realizimin e të ardhurave për vitet 2012 - 2013 dhe 10/mujori 2014, në mos evidentimin e debitorëve, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Komunës, veprime këto në kundërshtim me ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit dhe Kodit Penal i R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme

Rekomandim: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të komunës në bashkëpunim me Zyrën e financës, të marrë masa dhe organizojë punën në këto drejtime:

- në bashkëpunim me biznesin të hapen regjistrat e taksave vendore për subjektet fizike e juridike, në mënyrë manuale.
- të pajisen me kasë fiskale subjektet brenda juridiksionit të komunës Fan .
- të kryhen kontrolle nga punonjësi i Zyrës së Taksave në bashkëpunim me Zyrën e Financës, për të dhënat që realizojnë subjektet nga blerjet me vlera të vogla, apo shërbimet.
- të kërkojë regjistrimin e subjekteve në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- të evidentojë rast pas rasti krijimin e debitorëve për mos pagesën e detyrimeve tatimore .

- të kërkojë që ndaj subjekteve debitorë të vendoset barrë siguruese sipas rastit.
- të vendosen masë administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit) ndaj subjekteve në juridiksionin e komunës Fan për mos pagimi i taksave dhe tatimeve në afatet e përcaktuara.
- për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për vlerën **633,200 lekë**, të pasqyruara në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të nxirren njoftim vlerësimet, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar të veprohet:

a. Tu dërgohen Bankave Urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b. Ndaj personave debitorë, veçanërisht për taksën e tokës dhe ndërtimit, ti kërkohet vendosja e barrës siguruese (Drejtorinë Rajonale të Transportit Rrëshen për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Rrëshen kjo bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”.

c. Në rast se subjektet edhe pas njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, pasi tu vendosen masa ndëshkuese administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008), të procedohet me kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pikat 130-132 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodit Penal i R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Brenda muajit Maj 2015

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u evidentua se zyra e urbanistikës në komunën Fan funksionon me një specialist dhe në lidhje me vendimmarrjen nuk ekziston struktura e këshillit teknik apo KRRT-së, për rrjedhojë nuk janë kryer dhe nuk është miratuar Instrumenti i Përgjithshëm Vendor i Planifikimit të Territorit dhe për rrjedhojë nuk ka raste të dhënies së lejeve zhvillimore dhe të shfrytëzimit si dhe mos hapja e regjistrit të planifikimit të territorit në formë elektronike në zbatim të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 “Për planifikimi e territorit” i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Ky funksion i është deleguar Këshillit të Qarkut Lezhë, sipas vendimeve të këshillit të komunës Fan nr. 7, datë 16.03.2012 “Për delegim kompetencash KRRT-së Qarku Lezhë viti 2012”, vendim nr. 3, datë 22.01.2013 “Për delegim kompetencash KRRT-së Qarku Lezhë viti 2013” dhe vendimi nr. 11, datë 31.03.2014 “Për delegim kompetencash KRRT-së Qarku Lezhë viti 2014”.

Rekomadim: Komuna Fan të marrë masat për krijimin e strukturës së urbanistikës me specialistë të fushës përkatëse dhe më pas të kryejë studimin e përgjithshëm të territorit për t’ia paraqitur KKT për miratim.

Brenda muajit Maj 2015

8. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit është konstatuar se nuk është përmbyllur **faza e tretë** lidhur me hartimin e listave përfundimtare duke shkaktuar vonesa për kalimin në pronësi dhe transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore në favor të komunës dhe nuk është përmbyllur procesi i regjistrimit dhe inventarizimit të pyjeve dhe kullotave të kaluara në pronësi të Komunës Fan nëpërmjet VKM nr. 126, datë 03.02.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Fan të Qarkut të Lezhë, veprime këto në papajtueshmëri me nenin 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, nenin 45 të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 500, ,, për rrjedhojë nuk janë pasqyruar në kontabilitet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Komuna Fan të marrë masat për përmbylljen e fazës së tretë të miratimit për kalimin në pronësi dhe transferimit të pronave të paluajtshme Shtetërore në favor të komunës Fan me VKM dhe të kërkojë procedurat e regjistrimit në ZVRPP Mirditë pasuritë dhe pronat e transferuara me VKM nr. 126 datë 03.02.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Fan të Qarkut të Lezhë”, pasi të ketë përfunduar regjistrimin e pasurive në ZVRPP Mirditë, të nisë inventarizimin fizik dhe përfshirjen e vlerës në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël për zërat “toka, troje dhe terrene”, objekte të ndryshme, duke i pasqyruar në bilancin e vitit 2015.

Brenda datës 30.03.2015

8.1. Gjetje nga auditimi: Lidhur me administrimin, menaxhimin dhe mbarështimin e ekonomive pyjore, kullimore dhe livadheve konstatojmë se nga mos futja në efikasitet të resurseve si dhënia me qira e pyjeve, kullotave dhe livadheve, apo lëndë punimi a material drusor tjetër për përdorim a shitje për nevoja të komunitetit si dhe të ardhura të realizuara nga përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e faunës, rezulton se nuk është realizuar asnjë e ardhur për vitet 2012 deri 30.10.2014. Edhe nga kullotja e bagëtive nuk janë realizuar të ardhura, ku sipas evidencës të inspektorit veterinar evidentohen 3000 krerë të imta $\times 100$ lekë/krerë $\times 2$ vjet = 740,000 lekë si dhe gjedhe e njëthundrakë 1150 krerë $\times 800$ lekë/krerë $\times 2$ vjet = 920,000 lekë, pra kemi të ardhura të munguara.

Gjithashtu, nuk evidentohet dhënie me qira të 217 ha tokë bujqësore e pa ndarë dhe e pa regjistruar në emër të komunës Fan, për rrjedhojë ky fond toke bujqësore përdoret nga pronarët e vjetër, por pa dokument ligjor, si dhe të ardhurat për vendosjen e antenave të kompanive celulare përfitohen padrejtësisht nga këta persona e jo komuna. Ky mosveprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar dhe me VKM nr. 22, datë 9.01.2008, “Për Përcaktimin e procedurave dhe të Kriterëve të Administrimit të Pyllit Komunal”, pikat 3 e 4.

Rekomandim: Komuna Fan të marrë masat për hartimin e planit të menaxhimit e mbarështimi në pyje, kullota e livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, vjeljen e gjahut dhe të shërbimeve çlodhëse, dhënien me qira të pronave të veta etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve.

Brenda datës 30.03.2015.

9. Gjetje nga auditimi: Emërimi i punonjësve në strukturën e Policisë Komunës në 1 rast nuk është bërë në zbatim të procedurës dhe sa përcaktuar në dispozitat ligjore në fuqi, ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” i ndryshuar, neni 5, Urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”.

Rekomandim: Komuna Fan të marrë masa e të rekrutoj si punonjës e policisë komunës të kandidatë që të kenë marrë formimin në Akademinë e Rendit Publik apo Akademinë e Policisë së Rendit dhe emërimi në detyrë të bëhet me komision të posaçëm.

Menjëherë

9.1 Gjetje nga auditimi: Shumica e procesverbaleve për vitin 2012, 2013 të policisë komunës, janë të pa protokolluara. Në shumicën e rasteve në procesverbale nuk është referuar baza ligjore dhe nuk janë plotësuar fletë gjobe për shkeljet e konstatuara, në mbështetje me nenin 13 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës”. Për problemet e dala, konstatohet se nga inspektorët e Policisë së Komunës për vitin 2012 dhe 2013, nuk është vendosur asnjë gjobë dhe nuk janë tërhequr blloqe gjobash për shkeljet, duke e kthyer këtë sektor në inekzistent e formal.

Rekomandim: Komuna Fan të marrë masa që procesverbalet e policisë së komunës të protokollohen, dhe të gjitha dokumentet të plotësohen me referencat ligjore përkatëse dhe për shkeljet e konstatuara të plotësohen fletë gjoba.

10. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit është konstatuar se, në asnjë nga vitet nuk është nxjerrë lista e debitorëve për mos pagesën e detyrimeve, pra nuk janë evidentuar si debitorë në bilanc për vitet 2011, 2012 dhe 2013, ku nga auditimi u evidentuan debitor për shumën 633,200 lekë, në kundërshtim me ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandim: Të kryhet arkëtimi i vlerës **633,200 lekë**, sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për tatim pagues që nuk kanë shlyer detyrimet ndaj degës së tatim taksave Komuna Fan.

Brenda datës 31.03. 2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Zyra e Financës së Komuna, të marrë masa duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **352,424 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykit, konkretisht:

1. Gjetje nga auditimi: Nga zyra e financës është likuiduar tepër vlera 40,800 lekë sipas transaksionit nr. 46, datë 19.03.2012 për faturat tatimore të shitjes nr. 9, datë 15.03.2012 blerje pemë dekorative është shtuar vlera prej 10,800 lekë, nr. 95, datë 14.09.2012 blerje kancelari, është shtuar vlera 10,000 lekë, nr. 25, datë 24.09.2012 blerje kancelari, është shtuar vlera 10,000 lekë dhe nr. 29, datë 22.10.2012 blerje printer dhe riparim fotokopje, është shtuar vlera 10,000 lekë.

Rekomandim: Të kryhet arkëtimi i vlerës **40,800 lekë** nga z. G.K, për sa paguar më tepër, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe Kryetarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël, z.N. M dhe z.S.D në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.

Brenda datës 31.03. 2015

2. Gjetje nga auditimi: Nga zyra e financës është likuiduar tepër vlera 2,666 lekë sipas transaksionit nr. 163, datë 04.09.2012, dhe nr. 143, datë 27.09.2013 me objekt shpenzimi taksa vjetore për automjetet, institucioni ka paguar gjobë në vlerën 2.666 lekë për mos kryerje në kohë të kontrollit fizik të automjetit.

Rekomandim: Të kryhet arkëtimi i vlerës **2,666 lekë**, nga z. Gj.K në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Brenda datës 31.03.2015

3. Gjetje nga auditimi: Nga zyra e financës është likuiduar tepër vlera 12,000 lekë sipas transaksionit nr. 238, datë 07.12.2012, në vlerën 300,000 lekë me objekt shpenzimi “Projekt Qendra Spitalore 1 kat në qendër të komunës Fan” u konstatua se, operatori ekonomik nuk ka zbatuar nenin 2 “kohëzgjatja e kontratës dhe vlera” pika 2.1 ku cilësohet se, kohëzgjatja e kontratës së sipërmarrjes do të jetë jo më shumë se 45 ditë momenti i nënshkrimit të saj nga palët. Për arsye se, sipas akt marrjes në dorëzim shërbimi i projektimit është realizuar më datë 29.05.2012 ose 10 ditë më vonë. Autoriteti Kontraktor nuk ka aplikuar penalitete, për dorëzim të vonuar të shërbimeve **në vlerën 12,000 lekë**.

Rekomandim: Të kryhet arkëtimi i vlerës **12,000 lekë**, nga z. Gj.K, z. N.M dhe z. S.D, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit të projektimit.

Brenda datës 31.03. 2015

4. Gjetje nga auditimi: Nga zyra e financës është likuiduar tepër vlera 40,000 lekë sipas transaksionit nr. 246, datë 14.12.2012, në vlerën 275,000 lekë me objekt shpenzimi shpërblime viti 2012, me urdhrin nr. 20, datë 06.12.2012 bazuar në Vendimin e Këshilli të Komunës nr. 3 datë 12.01.2012 ‘Për miratimin e tregueseve të buxhetit të Komunës vitit 2012’, në kundërshtim me vendim Nr. 589, datë 05.09.2012 “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2012”, për rrjedhojë duhet të arkëtohen nga përfituesit .

Rekomandim: Të kryhet arkëtimi i vlerës **107,000 lekë** sipas urdhër shpenzimit nr. 246, datë 14.12.2012, sipas listës nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, për pagesë të padrejtë.

Brenda datës 31.05. 2015

5. Gjetje nga auditimi: Nga zyra e financës është likuiduar tepër vlera 60,000 lekë rimbursim i shpenzimeve të transportit ndaj titullarit NJQV, sipas urdhër shpenzimeve nr. 1, datë 08.01.2014, nr. 12, datë 04.02.2014, nr. 27, datë 05.03.2014 dhe nr. 42, datë 03.04.2014 në total në vlerën 60,000 lekë, është në kundërshtim me ligjin nr. 169/2013, datë 7.11.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” dhe përbën përfitim të pa drejtë në vlerën 60,000 lekë, e cila duhet të arkëtohet nga nëpunësi autorizues i NJQV.

Rekomandim: Të kryhet arkëtimi i vlerës **60,000 lekë** nga Gj,P, kryetar i komunës për pagesë të padrejtë shpenzime transporti.

Brenda datës 31.03. 2015

6. Gjetje nga auditimi: Nga zyra e financës është likuiduar tepër vlera 25,000 lekë, Komisioni i zhvillimit të procedurave të ankandit, nuk ka zbatuar seksionin “Vlerësimi i ofertave dhe zhvillimi ankandit, paragrafin “Vlefë e hapit të zhvillimit të ankandit do të jetë 2% e vlefës fillestare të ankandit”, të dokumenteve të ankandit faqe 12, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 25,000 lekë**, pasi kandidatit blerës nuk i është kërkuar dhënia e ofertave konform hapit të përcaktuar.

Rekomandim: Të kryhet arkëtimi i vlerës **25,000 lekë** nga z. Gj.K, z. Gj.Gj dhe znj. T.N në cilësinë e anëtareve të Komisionet të zhvillimit të procedurave të ankandit, për arsye se nuk kanë zbatuar seksionin “Vlerësimi i ofertave dhe zhvillimi ankandit, paragrafin “Vlefë e hapit të zhvillimit të ankandit do të jetë 2% e vlefës fillestare të ankandit”, të dokumenteve të ankandit .

Brenda datës 31.05.2015.

7. Gjetjet nga auditimi: Zyra e financës Komuna Fan ka likuiduar para afatit vlerën **104,958 lekë**, që i përket garancisë së punimeve për objektin “*Riparim dhe mirëmbajtje e rrugëve të brendshme të komunës Fan*”, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në buxhetin e komunës, veprim në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në nenin 21, të kontratës nr. 141, datë 17.06.2013 lidhur ndërmjet palëve dhe me pikën 8 të Udhëzimit nr. 1, datë 22.02.2005 “Për disa shtesa në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “ Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (Komuna Fan), të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **104,958 lekë**, nga 5 punonjës të komunës dhe mbikëqyrësi i punimeve, pasi kanë miratuar e kryer likuidimin e vlerës së garancisë së punimeve dhe marrjen në dorëzim të objektit, “*Riparim dhe mirëmbajtje e rrugëve të brendshme të komunës Fan*”, para afatit ligjorë të përcaktuar, të arkëtohet vlera **104,958 lekë** , përkatësisht:

- N.T 17,493 lekë, S.D 17,493 lekë, N.M 17,943 lekë, Gj.Gj 17,943 lekë, N.M 17,943 lekë, pasi kanë qenë me cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të objektit dhe z. Z.B, shumë 17,943 lekë, mbikëqyrës i punimeve të objektit.

Brenda datës 31.03. 2015

C. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenet 37, 141, 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe nr. 9125, datë 29.07.2003,” si dhe në kontratën individuale të punës, i kemi kërkuar Kryetarit të Komunës Fan të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, për 4 punonjësit si më poshtë:

“Vërejtje me paralajmërim nga puna”, për punonjësit :

1. z. Gj.K, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës, për mos hartimin dhe paraqitjen e projektvendimit të realizimit të buxhetit faktik për shqyrtim në Këshillin e Komunës, për mosrakordimin e treguesve të buxhetit të miratuar në Këshillin e Komunës me thesarin, dhe për mos analizimin e shpenzimeve operative (llog. 602) dhe rakordimin e tyre me degën e thesarit.

2. z. B.P, në cilësinë e juristit për mos nëshkrimin e projekt-buxheteve dhe paraqitjen e materialeve të tjera për shqyrtim në Këshillin e Komunës, në lidhje bazën ligjore të tyre.

3. z. S.D, në cilësinë e specialistit të investimeve në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të investimeve të kryera dhe dorëzimin e tyre në zyrën e financës sipas afateve dhe mos ndjekjen e problemeve të ndërtimeve në juridiksionin e Komunës Fan.

4. zj.T.N, në cilësinë e specialistit të Njësisë së Prokurimeve

Për arsye se:

- Nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi për objektin mbikëqyrje punimesh në objektin “Riparim dhe mirëmbajtje e rrugëve të brendshme të Komunës Fan 2013”, “Çmontim dhe montim Urë Bejli 20 ml Urakë-Domgjon”, “Riparim dhe mirëmbajtje e rrugëve të brendshme të Komunës Fan 2014”, “Rrethim i varrezave të fshatit Xhuxhe dhe fshatit Dardhaz”, në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 4 dhe 29 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Udhëzimin Nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pasi autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesit, nuk ka zbatuar asnjë nga procedurat e parashikuara në këtë ligj, duke cenuar parimet e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike, mos diskriminimit dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve dhe parimin e transparencës në procedurat e prokurimit, duke favorizuar kështu një operator ekonomik të caktuar.*(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 65-70 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

-Në të gjitha objektet ndërtimore projekti i zbatimit, shënimet teknike dhe preventivi nuk janë hartuar nga persona fizikë e juridikë, të pajisur me licencën përkatëse, në kundërshtim me nenin 5, kreu III të ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

-Në **17 raste** në vlerën 341,620 lekë blerja e punëve, mallrave dhe shërbimeve është kryer pa praktikë blerje me vlerë të vogël, në kundërshtim me nenin 29 pika 5, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 2 dhe VKM nr.1 datë 10.01.2010, i ndryshuar dhe Udhëzimet e APP-së “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, të ndryshuara.

- Ka copëzuar fondin në lidhje me objektin “Blerje peme dekorative”, në vlerën 987,800 lekë dhe “Mirëmbajtje rrugë të brendshme për vitin 2012” në vlerën 800,129 lekë, në kundërshtim me nenin 27 dhe pikën 5 të nenit 29 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

- Nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe në disa raste tepëricat e llogarive nuk pasqyrojnë të plotë e të saktë gjendjen, për arsye të mungesës së deklarimeve, për rrjedhojë hartimi i llogarisë vjetore nuk ka qenë sipas Planit Kontabël, “Për organet e pushtetit vendorë dhe njësit që varen prej tyre”.

5. z. N.T, 6. zj. L.L, 7. z. N. M, 8. z. Z. B, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për arsye se:

Kanë shqyrtuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik në tenderat e zhvilluara për vitin 2012, 2013 dhe Janar-Tetor 2015, në papajtueshmëri me nenin 53 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 4 e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 60-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.z. Gj.N me detyrë inspektor i taksave në zyrën e financës, për mos ndjekjen e detyrimeve tatimore të biznesit në juridiksionin e komunës Fan, mos evidentimin e debitorëve për vitet 2013 dhe 2014.

10. z. Gj. Gj, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për arsye se:

-Ka kualifikuar operatorin ekonomik ‘Alb Munell’, në papajtueshmëri me neni 36, pika 3 e ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar .

- Nuk ka zbatuar seksionin “Vlerësimi i ofertave”, paragrafin “Vlefëta e hapit të zhvillimit të ankandit”, të dokumenteve standarde, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 25,000 lekë. *(Trajtuar në faqet 60-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Nga Komuna Fan, nuk është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dëguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Qemal Meta, Agim Mandri, Shefki Jaupi dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT